

Komunitetet fetare në marshim paqeje në Elbasan



Vendi ynë, gjatë vitit që sapo lamë pas, u përball me sfida të ndryshme e të shumta, por që kulmuan me tërmetet e Shatorit dhe Nëntorit, duke sjellë pasoja të rënda, si me jetët e humbura nën rrënoja, ashtu edhe me shkatërrimin e banesave dhe ndërtesave në disa zona që tashmë i kemi parë dhe prekur shumë prej nesh, duke kontribuar sado pak në eliminimin e pasojave.

Kjo situatë sensibilizoi mbarë kombin e më gjerë duke na forcuar në vllazëri, por gjithashtu nxorri në pah shumë mangësi në disa drejtime dhe hallka, si gjatë precesit emergjent të shpëtimit, ashtu edhe më pas, në kujdesin për ushqim dhe strehim të të prekurve nga kjo fatkeqësi natyrore, gje që na fton të gjithëve të reflektojmë.

Kësisoj ne menduam dhe deshirojmë të nxisim këtë vit të gjithë aktorët dhe faktorët për të punuar në këtë drejtim, si në rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe individëve për një reagim sa më efikas në raste fatkeqësish të tilla, ashtu edhe në ndërgjegjësimin e sa më shumë njerëzve që të përfshihen në organizma dhe organizata që kanë si qëllim vullnetarizmin dhe bashkërendimin e veprimeve në





radiongjallja.org